

Prezantimi i të gjeturave fillestare nga Hulumtimi krahasues të sistemeve zgjedhore (Comparative Study of Electoral Systems) në Republikën e Maqedonisë së Veriut

22 janar 2025, Dhoma publike, Shkup, 11.00 - 13.00

Zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të vitit 2024 çuan në disa ndryshime në jetën politike të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Bartësit e funksioneve në pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ u zëvendësuan, në skenë u paraqitën ose u përforcuan aktorë të rinj politikë, udhëheqësia e një prej partive më të mëdha dhe të mëparshme në pushtet u ndryshua plotësisht dhe një nga partitë e përhershme në pushtet hyri në opozitë pas një periudhe më të gjatë. Në përgjithësi, duket se edhe një episod tjetër në demokracinë shumëpartiake maqedonase është mbyllur, duke sjellë aktorë, zgjidhje dhe probleme të reja në skenë, të cilat do të jenë në qendër të vëmendjes në periudhën e ardhshme.

Çfarë shpuri në këtë rezultat? Pse votuesit maqedonas vendosën për ndryshimet? Çfarë i motivon votuesit të votojnë për një parti ose kandidat të caktuar, ose të abstenojnë nga votimi? Kur vendosin se për kë do të votojnë? Cila është prirja e votuesve ndaj partive, kandidatëve dhe pozicioneve politike të ndryshme që dominojnë diskursin publik? Si qytetarët i pozicionojnë ideologjikisht partitë? Si i vlerësojnë votuesit zgjedhjet dhe sistemin në tërësi?

Me qëllim të kuptimit më gjithëpërfshirës të dinamikës në lidhje me zgjedhjet e vitit 2024, Instituti për Kërkime Sociologjike dhe Politiko-Juridike pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (IKSPJ-UKIM), në bashkëpunim me Institutin për Demokraci "Societas Civilis" Shkup (IDSCS) dhe Programin për mbështetje të zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut¹, gjatë vitit 2024 për herë të parë në vend e zbatuan modulën e Hulumtimit krahasues ndërkombëtar të sistemeve zgjedhore (HKSZ, Comparative Study of Electoral Systems, CSES, <https://cses.org/>). Zbatimi i parë i HKSZ në Maqedoninë e Veriut u mbështet gjithashtu edhe nga Fondacioni Kombëtar i Shkencës i SHBA në kuadër të Programit të Granteve Fillestare të HKSZ.

HKSZ/CSES është një sondazh ndërkombëtar, i koordinuar nga Qendra për Studime Politike pranë Universitetit të Miçiganit, SHBA dhe GESIS- Instituti i Shkencave Sociale në Lajbnc, Gjermani, i cili fokusohet në sjelljen elektorale të qytetarëve. Deri më tani, është zbatuar në 60 vende të botës në pesë diga të ndryshme që nga viti 1996. Zbatimi i modulit të gjashtë me radhë të HKSZ (2021-2026) në Maqedoninë e Veriut do të sigurojë të dhëna me cilësi të lartë dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht mbi sjelljen zgjedhore të qytetarëve që do të jetë në dobi të komunitetit shkencor, politikëbërësve, organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fushën e politikave zgjedhore dhe punonjësëve në media.

Programi për mbështetje të zgjedhjeve financohet nga Qeveria e Zvicrës dhe zbatohet nga Fondacioni ndërkombëtar për sistemet zgjedhore (IFES).

Rezultatet fillestare të hulumtimit anketues, i kryer në një mostër kombëtare prej 1056 respondentëve të zgjedhur me zgjedhje të rastësishme, do të paraqiten më 22 janar 2025, duke filluar nga ora 11.00 në Dhomën Publike në Shkup. Bashkohuni me ne për një diskutim, të mbështetur me të dhëna të freskëta anketuese, kushtuar dinamikës zgjedhore dhe politike në vend!

Gjuha e punës e ngjarjes është maqedonishtja, me atë që është siguruar përkthim simultan në shqip dhe anglisht.

A G J E N D A

22 janar 2025, 11.00 - 13.00
Dhoma publike, Divizioni i 50-të 22,
Shkup, <https://maps.app.goo.gl/SKUJXs8SBbJ5Rxv4A>

10.30-11.00 Arritja dhe regjistrimi i pjesëmarrësve

11.00-11.15 Hapja e ngjarjes, fjalime përshëndetëse të:
Prof. Dr. Bojana Naumovska, Drejtore e IKSPJ-UKIM
Marko Troshanovski, kryetar i IDSCS
Ioana Kosma, Drejtore e IFES për Maqedoninë e Veriut

11.15-12.00 Të gjeturat fillestare nga HKSZ:
Prof. Dr. Aneta Cekic, IKSPJ-UKIM
Doc. Dr. Jovan Bliznakovski, IKSPJ-UKIM

në bisedë me:
Prof. Dr. Nenad Markoviq, moderator
Fakulteti juridik "Justiniani i parë"- UKIM
Bashkëpunëtor i jashtëm i hulumtimit në IDSCS

12.00-12.30 Diskutim i hapur